

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Isa Shala dhe Rafet Haxhaj, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Posta dhe Telekom i Kosovës sh.a. në Prishtinë, kundër të paditurës N.SH. "... " nga Gjakova, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.nr.334/2008 i datës 18.12.2012, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 20.05.2016, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditurës N.SH. "... " nga Gjakova dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.nr.334/2008 i datës 18.12.2012.

II. NDRYSHOHET aktgjykimi C.nr.334/2008 i datës 18.12.2012 vetëm përkitazi me kamatën dhe gjykohet si vijon: **DETYROHET** e paditura që paditëses ti paguaj kamatën të cilën e paguajnë bankat në Kosovë sikurse për mjetet e deponuar pa destinim të caktuar përtej një viti, duke filluar nga data 10.04.2008 e gjer te pagesa definitive.

III. Aktgjykimi C.nr. 334/2008 i datës 18.12.2012 në pikën III të dispozitivit – pjesën refuzuese mbetet i paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar, në pikën I të dispozitivit është shfuqizuar aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit Ekz.nr.937/2008 i datës 10.04.2008 në pjesën që ka të bëjë me borxhin kryesor dhe shpenzimet. Në pikën II të dispozitivit pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar e paditura që paditëses ti paguaj në emër të borxhit për shërbimet telefonike për telefonin nr.326-533, për muajt Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2007, në shumën e përgjithshme prej 176, 68 €, me kamatë në lartësi prej 3,5%, të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 10.04.2008 e deri në pagesën definitive si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit e nën kërcënim të

përmbarimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që kërkesëpadia mbi shumën e aprovuar në shumë prej 8.44 € për muajin Mars dhe pjesërisht për muajin Prill të vitit 2007 është refuzuar si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar duke vendosur në favor të paditurës ose i njëjti të priset dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë nuk ka pas.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Posta dhe Telekom i Kosovës sh.a. në Prishtinë ka ushtruar padi kundër të paditurës N.SH. "... " nga Gjakova për shkak të pagesës së borxhit, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadiës, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata në procedurën e provave ka bërë nxjerrjen e provave përmes faturave të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar dhe pas vlerësimit të njëjtave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, dispozitave të nenit 17.par.1 të LMD-së si dhe dispozitave të nenit 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, me arsyetim se gjykata në bazë të provave të administruara në mënyrë të padyshimtë ka vërtetuar se e paditura i ka shfrytëzuar shërbimet e paditëses në bazë të marrëdhënies kontraktuese përmes shpenzimit të telefonit nr.326-533, ashtu që e paditura të njëjtën e ka shfrytëzuar prej muajit Mars të vitit 2007 e gjer me datë 31.12.2007 dhe gjykata e detyroj të paditurën që ta përmbush detyrimin ndaj paditëses duke u mbështetur në dispozitën e nenit 17.par.1 të LMD-së i cili përcakton se pjesëmarrësin në marrëdhëniet detyimore kanë për detyrë të zbatojnë detyrimet e veta dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre, se e paditura posedon legjitimitetin pasiv, pasi që faturat emërohet në emër të tij dhe të njëjtat i ka pranuar dhe në aftin e përcaktuar ligjor nuk e ka kundërshtuar. Kërkesëpadinë përtej pjesës së gjykuar dhe atë obligimin e paditëses për muajin Mars të vitit 2007 sipas faturës 140522722007 të datës 07.04.2007 në bazë të së cilës e paditura është detyruar që paditëses ti paguaj shumën prej 633 €, ndërsa sipas faturës nr.145431762007 të datës 21.05.2007 në bazë të së cilës e paditura detyrohet që paditëses ti paguaj shumën prej 2.11 € apo shumën e përgjithshme prej 844 €, e ka refuzuar si të pabazuar në kuptim

të dispozitave të nenit 378 par.1 të LMD-së, pasi që kërkesa për këtë periudhë është parashkruar sepse ka kaluar afati prej një viti për shërbimin e kryer, e duke marrë parasysh faktin se propozimi për përmbarim në gjykatë është paraqitur me datë 10.04.2008, e i cili fakt është vërtetuar nga vula e pranimit të gjykatës.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket pjesës vërtetuese, ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozitat ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të paditëses, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, pasi që në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë dhe provave të theksuara, gjykata ka vepruar drejtë kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195.1 nën d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

Përkitazi me kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, me këtë aktgjykim në pikën II, gjykata e shkallës së dytë e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë konformë dispozitave të nenit 195.1 e) lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por pasi që në këtë gjendje të vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, aktgjykimi i atakuar përkitazi me kamatën është dashur të ndryshohet.

Kjo gjykatë vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që në këtë pjesë nuk pati ankesë.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.321/2013 më dt. 20.05.2016

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,